



REPubLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman
VENDIM

Nr 2 Datë 14/04/2010

Për

miratimin që Kryetari i Keshillit të Basenit të propozoi Keshillit Kombëtar të Ujit Tirane që zonën përreth burimit të Bogoves Qarku Berat ta shpallë si zonë e mbrojtjes së vecante.

Në mbështetje të neneve 40, 41 dhe 42 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore" dhe të & III, pika 2.8.B të vendimit nr. 3, datë 19.07.2002 të KJU "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të KJU, Këshillavë të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjencive të Ujit", Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin që Kryetari i Keshillit të Basenit i propozoi Keshillit Kombëtar të Ujit Tirane që zonën përreth burimit të Bogoves Qarku Berat ta shpallë si zonë e mbrojtjes së vecante.

Zona të përcaktohet nga një grup ekspertësh të përfaqësuar nga :

- 1-Ministria e Burimeve Minerare të Ekonomisë dhe Energjitikës.
- 2-Ministria e Transporteve, Pëneve Publike dhe Telekomunikacionit.
- 3-Ministria e Mjedisit dhe Administrimit të Ujrave
- 4-Ministrisë së Shëndetësisë
- 5-Perfaqësues nga Drejtoria e U.K. Berat
- 6-Perfaqësues nga Agjencia e Ujit Basenit Seman

Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Ajen GRABOVA



KRYETARI I KBU
SEMAN

Bujar HASAJ

